

Terma Reference

Projekti “Maratona e Tiranës”

I. Informacion i Përgjithshëm:

Autoriteti Kontraktues: Shoqata “URA”
Emri i Projektit: “Maratona e Tiranës”
Kontakti: Uarda Koçi
ukoci@ura.org.al

II. Pak mbi projektin:

Përshkrim i shkurtër i projektit.

Maratona e Tiranës është event i sportiv më i madh në kryeqytet, i cili përbëhet nga disa segmente vrapimi dhe kategorish gjithëpërfshirëse për publikun. Numri më i lartë i pjesëmarrësve vjen nga të rinjtë në këtë event. Itinerari i Maratonës së Tiranës përshkruan akset më të rëndësishme të Tiranës.

Të pranishëm në Maratonë janë jo vetëm shqiptarët por edhe të huajt, të cilët shprehin interes të lartë në pjesëmarrjen në Maratonë.

III. Objektivat e zërave për të cilat hapet kjo thirrje:

Zërat për të cilat hapet kjo thirrje janë:

Linjat e buxhetit	Njësia	Sasia
Prodhim T-Shirt (Kategoria Fun Run)	Copë	2860
Prodhim T-Shirt Garues	Copë	2500

IV. Fondi

Fondi nuk do të jetë i përcaktuar publikisht por subjektet kërkohet që të nisin me dokumentacionin e tyre edhe një ofertë të përcaktuar shumë që ata kërkojnë për zhvillimin e punës.

V. Afatet Kohore:

Afati kohor për përfundimin e shërbimeve të parashikuara përkon me planin e aktiviteteve.

VI. Dokumentet për tu paraqitur së bashku me Ofertën Financiare:

Subjektet kërkohet të paraqesin dokumentet e listuar më poshtë së bashku me Ofertën Financiare.

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - nuk është në konflikt interesi.
2. Kopje e NIPT-it.
3. Ekstrakt QKB

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose nga autoritetet përkatëse, si dhe vetë deklarin e subjektit.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jo fitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet:

1. Ekstrakt Historik lëshuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “për Organizatat Jo Fitimprurëse”.
4. Një dokument, të lëshuar nga Administrata tatimore që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka shlyer detyrimet fiskale;
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet referuar sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
5. Kopje të NIPT-it.

Oferta Financiare, që do të dorëzohet nga Operatorët ekonomikë të ftuar duhet të listojë të gjitha kostot që lidhen me këtë shërbim. Kostot duhet të ndahen sipas zërave të parashikuara. Operatorët ekonomikë të ftuar duhet të theksojnë çmimin e shërbimeve të tyre vetëm në monedhën Shqiptare (Lek).

VII. Kriteret e Vlerësimit:

Komisioni i Vlerësimit të ofertave, do të vlerësojë ofertat në bazë të çmimit më të ulët si dhe sipas dokumentacionit mbështetës që do të paraqesin subjektet. Këto kriteret janë të vetmit që përcaktojnë ofertuesin më të mirë, duke marrë në konsideratë elementët specifikë statikë të cilësuar në Termat e referencës dhe specifikimet teknike.

Hapat që do të ndiqen nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave:

- (i) **Kontrolli administrativ i Ofertuesve ekonomikë**
- (ii) **Propozimi financiar.**

Do të refuzohen ofertat në këtë fazë në rast se nuk i përgjigjet aspekteve më të rëndësishme të Termave të Referencës aktuale.

Shoqata URA ruan të drejtën e përzgjedhjes së subjektit, pa u ndikuar nga të tretë.

VIII. Afati i paraqitjes së dokumenteve

Dokumentet e kërkuara dhe propozimi financiar duhet të paraqiten brenda **2 diteve kalendarike** nga data e publikimit të kësaj thirrje. Ato duhet të dorëzohen pranë Shoqatës URA dhe nëse do të jenë fituese atëherë do të duhet të sjellin dorazi të gjitha dokumentet e sipërpërmendura.

President Shoqata “URA”

Eris Todri